



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 400/01-11669/26
Kaçanik, 29.05.2026

Mbështetur në nenin 24 dhe nenin 40.2 pika (b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 27 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ((Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/03 Qershor 2008), të nenit 2 të Ligjit 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/03 Qershor 2008) si dhe Ligjit për Ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/03 Gusht 2016), të nenit 6 dhe nenit 8 të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 (Gazeta Zyrtare Nr. 4/ 02 Mars 2026) të nenin 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës nëpërmjet Drejtorisë për Buxhet dhe Financa 01Nr. 400/01-11669/26 prej datës 19.05.2026, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 maj 2026, mori këtë

V E N D I M

PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE TË PASHPENZUARA NGA VITET PARAPRAKE NË BUXHETIN E KOMUNËS PËR VITIN 2026

1. Me këtë Vendim bëhet bartja e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake në buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2026.
2. Shuma e mjeteve për bartje nga viti fiskal 2024 në vitin fiskal 2026 është **118,961.99 euro**, ndërsa shuma e mjeteve për bartje nga viti fiskal 2025 në vitin fiskal 2026 është **311,573.35 euro**, përfshirë edhe tejkalimin e të hyrave vetanake. Totali i mjeteve të pashpenzuara nga vitet paraprake, të cilat kërkohen të barten në vitin 2026, është në shumë prej **430,535.34 euro**.
3. Buxheti i Komunës së Kaçanikut i miratuar për vitin 2026 në shumë prej **13,399,753.00 euro**, pas bartjes së mjeteve të pashpenzuara nga vitet paraprake në shumë prej **430,535.34 euro**, arrin shumën e përgjithshme prej **13,830,288.34 euro**.
4. Shuma e planifikuar e të hyrave vetanake për vitin 2025 ka qenë **950,401.00 euro**, ndërsa realizimi total i të hyrave vetanake, direkte dhe indirekte, është **1,038,093.54 euro**. Tejkalimi i të hyrave vetanake rezulton në shumë prej **87,692.54 euro**, mjete këto të cilat përfshihen në bartje dhe planifikohen për financimin e aktiviteteve, obligimeve dhe projekteve të përcaktuara me këtë vendim.

5. Mjetet e pashpenzuara në shumë prej **430,535.34 euro**, planifikohen të barten sipas kategorive ekonomike si vijon:

- Mallra dhe Shërbime, shuma 102,282.04 euro;
- Shpenzime Komunale, shuma54,808.58 euro;
- Subvencione dhe Transfere, shuma35,000.00 euro dhe
- Investime Kapitale, shuma 238,444.72 euro.

Në kategorinë ekonomike *Mallra dhe Shërbime*, shuma totale 102,282.04 euro shpërndahet në nënprogramet buxhetore si vijon:

16328 – Administrata, shuma 20,000.00 euro.

Bartja e mjeteve në këtë kategori bëhet për plotësimin e buxhetit në kuadër të Administratës, me qëllim të mbulimit të nevojave operative, furnizimeve, shërbimeve administrative dhe shërbimeve tjera të domosdoshme për funksionimin e rregullt të administratës komunale gjatë vitit 2026.

18028 – Shërbime Publike – Infrastruktura Rrugore, shuma 42,282.04 euro.

Bartja e mjeteve në këtë kategori bëhet për përmbushjen e nevojave të shtuara në kuadër të Shërbimeve Publike, veçanërisht për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore, mirëmbajtjen e hapësirave publike, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjet investive dhe shërbime tjera të domosdoshme.

18432 – Zjarrfikësit dhe Inspektimet, shuma 5,000.00 euro.

Bartja e mjeteve bëhet për plotësimin e buxhetit në kategorinë Mallra dhe Shërbime, me qëllim të mbulimit të nevojave operative, furnizimeve dhe shërbimeve të domosdoshme për funksionimin e rregullt të njësisë gjatë vitit 2026.

66445 – Planifikimi, Urbanizmi dhe Inspekcioni, shuma 15,000.00 euro.

Bartja e mjeteve në këtë kategori bëhet për mbulimin e nevojave operative, duke përfshirë shërbime profesionale, hartim të projekteve dhe shërbime tjera që lidhen me planifikimin urban dhe zhvillimin e projekteve komunale.

85028 – Shërbimet Kulturore, shuma 20,000.00 euro.

Bartja e mjeteve bëhet për plotësimin e buxhetit në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, me qëllim të mbulimit të nevojave që lidhen me mirëmbajtjen, funksionimin e rregullt dhe shfrytëzimin e objekteve kulturore, rinore dhe sportive. Mjetet do të shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin normal të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive gjatë vitit 2026.

Në kategorinë ekonomike *Shpenzime Komunale*, shuma totale 54,808.58 euro shpërndahet në nënprogramet buxhetore si vijon:

16328 – Administrata, shuma 15,000.00 euro.

Bartja e mjeteve bëhet për mbulimin e shpenzimeve komunale të administratës, përkatësisht energjisë elektrike, ujësjellësit, kanalizimit, mbeturinave dhe shërbimeve tjera komunale. duke

marrë parasysh nivelin e shpenzimeve të deritanishme dhe nevojën për sigurimin e mjeteve të mjaftueshme deri në fund të vitit fiskal.

18028 – Shërbime Publike – Infrastruktura Rrugore, shuma 10,000.00 euro.
Bartja e mjeteve bëhet për mbulimin e shpenzimeve komunale në kuadër të Shërbimeve Publike, kryesisht për obligime që lidhen me ndriçimin publik dhe shërbimet tjera komunale.

93810 – Arsimi Fillor, shuma 17,000.00 euro.

Bartja e mjeteve bëhet për mbulimin e shpenzimeve komunale në shkollat fillore, përkatësisht për energji elektrike, shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit, mbeturina. Nevoja për plotësim të buxhetit është paraqitur edhe si rezultat i rritjes së kostos së energjisë elektrike.

95010 – Arsimi i Mesëm, shuma 12,808.58 euro.

Bartja e mjeteve bëhet për mbulimin e shpenzimeve komunale në shkollat e mesme, përkatësisht energjisë elektrike, shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, mbeturinave dhe obligimeve tjera komunale, duke marrë parasysh nevojat e paraqitura dhe nivelin e shpenzimeve të deritanishme. Nevoja për plotësim të buxhetit është paraqitur si rezultat i rritjes së kostos së energjisë elektrike.

Në kategorinë ekonomike *Subvencione dhe Transfere*, shuma totale 35,000.00 euro shpërndahet në nënprogramet buxhetore si vijon:

95010 – Arsimi i Mesëm, shuma 35,000.00 euro.

Bartja e mjeteve në këtë kategori bëhet për subvencionimin e transportit të nxënësve të shkollave të mesme gjatë vitit 2026. Këto mjete planifikohen me qëllim të mbështetjes së nxënësve në vijimin e rregullt të procesit mësimor.

Në kategorinë ekonomike *Investime Kapitale*, shuma totale 238,444.72 euro shpërndahet në nënprogramet buxhetore dhe projektet kapitale si vijon:

18028 – Shërbime Publike - Infrastruktura Rrugore

projekti me kod 55191 “Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në rrugën ‘Fadil Bunjaku’ – fshati Biqec”, shuma 15,314.14 euro.

Bartja e mjeteve bëhet për pagesën e situacionit të fundit dhe përmbylljen e obligimeve të mbetura nga kontrata aktive për këtë projekt. Nevoja për plotësim të buxhetit është paraqitur edhe për shkak se nga ky projekt janë ekzekutuar pagesa për vendime gjyqësore/përmbartimore që lidhen me obligimet nga Kontrata Kolektive në Arsim, duke ndikuar në zvogëlimin e mjeteve të planifikuara për realizimin e projektit gjatë vitit 2025.

48028 – Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik

projekti me kod 56175 “Ndërtimi i ballkonit panoramik”, shuma 4,395.65 euro.

Bartja e mjeteve bëhet për përmbylljen e obligimeve kontraktuale të bartura nga viti i kaluar, përkatësisht për pagesat e mbetura në kuadër të këtij projekti.

66445 – Planifikimi, Urbanizmi dhe Inspekcioni,

projekti me kod 53949 “Ndërtimi i nënkalimit për këmbësorë nën hekurudhën e qytetit”, shuma 8,107.25 euro.

Bartja e mjeteve bëhet për mbylljen e kontratës dhe përmbushjen e obligimeve të mbetura kontraktuale në kuadër të këtij projekti.

projekti me kod 55167 “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane – Kaçanik”, shuma 154,396.63 euro.

Bartja e mjeteve bëhet për realizimin e projektit në pjesën urbane të qytetit, përkatësisht në rrugën kah Çarshia e Vjetër dhe rreth Xhamisë, me qëllim të sigurimit të mjeteve të nevojshme për realizimin e projektit sipas planifikimit.

74700 – Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor – Kaçanik

projekti me kod 54429 “Ndërtimi i Depos dhe Garazhës në QKMF”, shuma 56,231.05 euro. Bartja e mjeteve bëhet për plotësimin e buxhetit të projektit, me qëllim të realizimit të punëve të parapara dhe përmblylljes së obligimeve kontraktuale. Nevoja për plotësim të buxhetit është paraqitur edhe për shkak të zvogëlimit të mjeteve të projektit si rezultat i ekzekutimit të pagesave për vendime gjyqësore/përmbartimore gjatë vitit 2025, që lidhen me obligimet nga Kontrata Kolektive në Arsim, duke ndikuar në pamjaftueshmërinë e mjeteve të planifikuara për realizimin e projektit. Mjetet e bartura planifikohen me qëllim të funksionalizimit dhe përfundimit të projektit gjatë vitit 2026.

6. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë pasqyrat tabelare të balanceve të mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, si dhe pasqyrat e shpërndarjes së mjeteve të bartura në nënprogramet përkatëse, kategoritë ekonomike dhe projektet kapitale, në përputhje me këtë Vendim.

7. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, e cila pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, të njëjtin vendim do ta përcjellë në Ministrinë e Financave për procedim të mëtejshëm.

8. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2021- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, ndërkaq do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë), Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit

Selajdin Troni

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA/VLADA/GOVERNMENT

MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE/MINISTRY OF FINANCE

Nr. i origjinalit: 0210/HAR/P
Org. e Jedishtes: 1122-1/2026
Org. e Unit: 15.06.26

Prishtine/PRISTINA/PRISHTINA



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance

Për:	Sabedin Vishi Kryetar i Komunës së Kaçanikut	
	Selajdin Tronin, Kryesues i Kuvendit të Komunës	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Hysni Mehani, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave	
	Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave	
Nga:	Bora Duli, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave	Datë: 08.06.2026
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë: 110/2026	
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Medina Millaku, Zyrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislationit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave	
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj, Udhëheqëse e Divizionit për Politika Buxhetore, Ministria e Financave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar z. Vishi,
I nderuar Kryesues z. Tronin,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 9 dhe 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

<i>Vendimin 01 Nr.400/01-11669/26 për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake në buxhetin e komunës për vitin 2026.</i>
<i>I miratuar me datë 29.05.2026</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 03.06.2026</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave më datë 04.06.2026.</i>

Ministria e Financave, (këtej e tutje referuar si “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Kaçanikut, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Kaçanikut, me anë të aktit administrativ komunal synon bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake në buxhetin e komunës për vitin 2026.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se proceset e mësipërme evidentohen edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si “LMFPP”) dhe Ligjit Nr.10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.
3. Në shqyrtimin e mundësisë së Komunës për realizimin e aktit administrativ komunal, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si “LMFPP”). Po ashtu, është konsultuar Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligji Nr.10/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.
4. Kështu, në kuptim të ndarjeve buxhetore komunale, nenj 8, paragrafi 6 dhe 7 i Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2026, përcakton se në rast se shuma e të hyrave vetanake të Komunës gjatë vitit i kalojnë shumat e të hyrave të ndara të asaj komunë ato mjete barten në vitin 2026, si në vijim:

Neni 8

Ndarja dhe ri-ndarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak

6. Bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2025 dhe vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2026 sipas vendimit të Kuvendit Komunal dhe autorizimeve të LMFP-së.

7. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2025 dhe të regjistruara në SIMFK që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për vitin 2025, barten në vitin 2026 në përputhje me vendimin e Kuvendit Komunal. Prioritet duhet të ketë ndarja e mjeteve për mbulimin e detyrimeve ekzistuese kontraktuale apo detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

5. Po ashtu, sipas nenit 27 të LMFP ndarjet buxhetore që ndërlidhen me të hyrat vetanake të pashpenzuara të komunës do të vazhdojnë për komunën përkatëse në vitin e ardhshëm fiskal, si në vijim:

Neni 27

Skadimi i ndarjeve buxhetore në fund të vitit fiskal



Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal do të skadojnë në mesnatën e 31 Dhjetorit, me përjashtim të ndarjeve buxhetore të cilat ndërlidhen me të ardhurat vetanake të pashpenzuara të komunave, apo të ndonjë organizate tjetër buxhetore të cilës i janë lejuar me ligj, e të cilat barten në vitin vijues.

6. Si përfundim, dhe duke marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria e Financave evidenton se komunave u lejohet që të bartin në vitin 2026 të hyrat vetanake të realizuara dhe të pashpenzuara gjatë vitit 2025. Megjithatë, zbatimi i suksesshëm i këtij vendimi varet nga përputhshmëria e dokumenteve përkatëse me rekomandimet e Departamentit të Buxhetit, për shkak të të cilave Vendimi mund të pësojë ndryshime nga aspekti teknik.
7. Si përfundim, dhe duke marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria e Financave evidenton se akti komunal i komunës së Kaçanikut është nxjerrur konform legjislacionit në fuqi, megjithatë, zbatimi i suksesshëm i këtij Vendimi varet nga përputhshmëria e dokumenteve përkatëse me rekomandimet e Departamentit të Buxhetit.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Arton Almeti, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave		
Kopje:	Kryelari i Komunës së Kaçanikut Kryesuesi i KK – Kaçanik Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL		
Përmes:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL		
Nga:	Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor		Date: 04.06.2026 VI- 020-386
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshëm të Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit		
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshëm të Akteve Komunale		
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse			
Lënda:	Shkresë përcjellëse në MF		
Lloji i aktit:	Vendim		

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar: Vendimin 01Nr.400/01-11669/26 për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake në buxhetin e komunës për vitin 2026, i miratuar në Kuvendin e Komunës së Kaçanikut dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe në nenet 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 01Nr.400/01-11669/26 për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake në buxhetin e komunës për vitin 2026

I miratuar më datë: 29.05.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.06.2026